

**MARRËVESHJE PER SHITJEN E KUOTËS**  
**PËR SHITJEN DHE BLERJEN E 50% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË**  
**"MAUCINI ShPK"**

Sot në Tiranë, më datë 19.02.2019 , është nënshkruar kjo Marrëveshje:

**NGA DHE NDËRMJET**

**Zj. Federica Daidone**, lindur ne Torino (Itali), me date 18.03.1978, banuese ne Torino (Itali) e identifikuar nëpërmjet pasaportës N. AS7598762, me zotësi te plete për te vepruar, ne cilësinë e saj te ortakut prej 50% te shoqërisë se te drejtës shqiptare Maucini ShPK (di ne vazhdim "**Shitësi**");

- nga njëra anë-

**DHE**

**Z. Mirko Daidone**, lindur ne Torino (Itali), me date 9.10.1973, banuese ne Tirane (Shqipëri) i identifikuar me pasaportën N.AA3748953, me zotësi te plete për te vepruar, ne cilësinë e saj te ortakut prej 50% te shoqërisë se te drejtës shqiptare Maucini ShPK ( ne vazhdim "**Blerësi**";

- nga ana tjetër -

Shitësi dhe Blerësi në vijim referuar së bashku "**Palët**" dhe veçmas si "**Pala**".

**NENI I**  
**Anekset**

Anekset e listuara përbëjnë një pjesë integrale dhe thelbësore të kësaj Marrëveshjeje.

## **NENI II**

### **2.1 Transferimi i Kuotave**

Në përputhje dhe zbatim të afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshje, Shitësi merr përsipër t'i shesë Blerësit, i cili merr përsipër të blejë Kuotat të cilat përfaqësojnë 50% të gjithë kapitalit të Shoqërisë.

Si rezultat, struktura e re e shoqërisë në momentin e Mbylljes do të rezultojë si më poshtë:

Blerësi do të zotërojë 1 kuote, që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Kuotat blihet nga Blerësi të lira dhe pa asnje Peng të regjistruar, për rrjedhojë nga data e Mbylljes, Blerësit i jepen të gjitha të drejtat që lidhen me Kuotat, duke përfshirë por pa u kufizuar tek, e drejta e votës dhe çdo e drejtë tjetër mbi dividendin e pagueshme ose aktualisht e paguar pas datës së Mbylljes. Kuota e Shoqërisë transferohet me të gjithë asetet përkatëse ose ato që lidhen me to që zotërohen ose përdoren nga Shoqëria në lidhje me aktivitetin e saj tregtar, duke përfshirë por pa u kufizuar në marrëveshje mirëbesimi, kontrata në vazhdimësi, pajisje teknike në teresi, *server* dhe *hardware* etj. si edhe çdo e drejte e arrire perpara ose pas dates se Mbylljes.

Aseti i vetëm i Shoqërisë përfaqësohet nga kapitali aksionar i paguar në llogarinë rrjedhëse të tij.

### **2.2 Çmimi i blerjes dhe format e pagesës**

Çmimi i blerjes që Blerësi i detyrohet Shitësit për blerjen e Kuotave është miratuar nga Palët në shumën totale të detajuar në vijim:

#### **(i) 1 kuote, që përfaqësojnë 50% të kapitalit, do te shitet me pagesën e shumes prej LEKE 100**

Çmimi i Blerjes nuk do të jetë subjekt i ndonjë miratimi, vetëm nëse ekzistojnë kushte që ndikojnë ndjeshëm vlerën e saj efektive.

Duke pasur parasysh sa më sipër, Blerësi merr përsipër të paguajë Shitësin cmimin e Blerjes në datën e sotme njëperjmet e transferim bankar.

## **NENI III**

### **3.1 Data e Mbylljes**

Mbyllja e transaksionit sipas kësaj Marrëveshje do të kryhet ne daten e firmosjes se kesaj kontrate.

### **3.2 Veprimet e Mbylljes**

Në datën e Mbylljes, Palët do të kryejnë të gjithë veprimet e mëposhtme, dorëzimet, dhe formalitet, përvèç çdo veprimi tjetër që kërkohet të kryhet në Datën e Mbylljes sipas kësaj Marrëveshje.

#### **3.2.1 Detyrimet e Shitësit**

Shitësi duhet ti dorëzojnë Blerësit certifikatën e regjistrimit të transferimit të Kuotave në favor të Blerësit të lëshuar nga QKR.

### *3.2.2 Detyrimet e Blerësit*

Blerësi bie dakord dhe merr përsipër të paguaj Çmimin e Blerjes, taksat, detyrimet, debitë dhe shpenzimet (përfshirë shpenzimet notoriale) në lidhje me transferimin e Kuotave sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara ketë kontrate.

## **NENI IV**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **4.1 Tërësia e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje përcakton të gjithë marrëveshjen dhe mirëkuptimin mes Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson çdo angazhim, marrëveshje apo deklaratë të mëparshme ndërmjet Shitësit dhe Blerësit.

#### **4.2 Ndryshimet**

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të konsiderohet i vlefshëm, përveç kur është rënë dakord në mënyrë të shkruar nga Palët.

#### **4.3 Efektshmëria**

Çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje, e cila është e ndaluar ose e pa zbatueshme, do të jetë e paefektshme në masën e ndalimit dhe pa zbatueshmërisë, pa ndikuar në dispozitat e mbeturë të kësaj Marrëveshje. Megjithatë, Palët marrin përsipër që të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zëvendësuar dispozitat e pavlefshme me ato të vlefshmet, të hartuara për të arritur, sa më shumë të jetë e mundur, të njëjtat efekte ekonomike si të dispozitave të pavlefshme.

#### **4.4 Heqja dorë**

Çdo tolerancë ose heqje dorë nga çdo Palë të një shkelje të një dispozite të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të konsiderohet heqje dorë e të drejtave që rrjedhin nga dispozita e shkelur ose e së drejtës për të kërkuar përbushjen e të gjitha kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

#### **4.5 Konfidencialiteti**

Çdo e dhënë, lajm, dokument apo informacion që lidhet me Marrëveshjen, transaksiioni i parashikuar këtu, do të konsiderohen si rreptësisht private dhe konfidenciale dhe nuk do t'ju bëhen të ditur palëve të treta (përjashtuar këtu bankën dhe ndonjë institucion tjetër financiar të cilët financojnë blerjen e Kuotave nga Blerësi), pa marrë miratimin paraprak të shkruar të Palës tjetër, e cila do të bie dakord për çdo komunikim ndaj palëve të treta lidhur me transaksiionin parashikuar nga Marrëveshja, pa cënuar komunikimet e detyrueshme të parashikuara nga Ligji i Zbatueshëm.

#### **4.6 Tarifat dhe shpenzimet**

Blerësi do të përballojë të gjitha shpenzimet dhe kostot notariale në lidhje me nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje. Secila nga Palët do të përballojë të gjitha shpenzimet dhe kostot vetjake në lidhje me negocimin dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshje.

#### **4.7 Ligji i Zbatueshëm**

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në bazë të Ligjit të Zbatueshëm.

#### **4.8 Gjuha**

Kjo Marrëveshje është përpiluar në gjuhën italiane dhe shqipe me të njëjtën vlerë ligjore. Në rast konflikti midis dy gjuhëve, versioni në gjuhen italiane do të mbizotërojë dhe do të jete i vetmi version që do të udhëheqë.

#### **4.9 Juridiksoni**

Të gjitha konfliktet që lindin nga apo në përputhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

SHITESI



FEDERICA DAIDONE



BLERESI



MIRKO DAIDONE